



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



**KONTRATA PUBLIKE KORNIZË**  
**616-21-3073-2-2-1/C644**

**KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;  
dhe

**DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K., Taslixhe II, PRISHTINË**, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për Shërbimet në vijim: "Deratizimi,dezinfektimi dhe dezinspektimi ne objektet shendetesore" me numër identifikues: 616-21-3073-2-2-1

**Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim: "Deratizimi,dezinfektimi dhe dezinspektimi ne objektet shendetesore"

<i>Nr.</i>	<i>Grupi</i>
<b>1</b>	<b>Deratizimi,dezinfektimi dhe dezinspektimi ne objektet shendetesore</b>

[Autoriteti kontraktues kryen blerje vetëm në emër të vet]

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve që duhet të performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i(të) detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurorë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi nga data që do të caktohet në planin e menaxhimit dhe është valide 36 muaj nga ajo datë.

**Neni 2 Koha e përfundimit**

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të caktohet me marrëveshje në mes të menaxherit dhe kryesit të shërbimeve dhe do të ceket në planin e menaxhimit.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë në objektet shendetesore.

### **Neni 3 Çmimi**

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

Vlera totale indikative e kontratës është 59 482,50 Euro (Pese dhjete e nente mije e katër qind e tete dhjete e dy euro e pese dhjete eorcent) Derivimi i lejuar nga vlera totale indikative është [+/- 30].

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njërive do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

### **Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës**

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.





### **Neni 5 Komunikimet**

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhën shqipe në kater origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Emri:	Zekë Bardhaj	Emri:	LULZIM KATANOLU
Pozita:	Udhëheqës i Prokurimit	Pozita:	DREJTOR
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	16.07.2021	Data:	16.07.2021
Vula:		Vula:	

## KUSHTET E PËRGJITHSHME

### Neni 1 Përkufizimet

1.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 “Shërbimet” do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 “Ofrues i shërbimeve” është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 “Personeli” do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 “Çmimi i kontratës” do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 “Nënkontraktuesi” do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 “Palë” nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe “Palët” nënkupton të dy prej tyre.

1.8 “Autoriteti Kontraktues” nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 “KPK” nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 “KVK” nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

### Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

### Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

#### **Neni 4 Nën-kontraktimi**

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertes. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditësh pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktonte pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Të gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshme.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njihë lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të sigurojë, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

#### **Neni 5 Tatimi**

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit të shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

#### **Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve**

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundojë aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktivitetëve.

#### **Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit**

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës;
- b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftojë Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

## **Neni 8 Forca Madhore**

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

## **Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues**

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

(a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitohet ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;

(b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

(c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

(d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;

(e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;

(f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paafësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

#### **Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve**

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paafë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

#### **Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve**

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofruesi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai,

duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrin. Ekzekutimi i urdhrin administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përmbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuar në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuar.

## **Neni 12 Obigimet e Autoritetit Kontraktues**

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

## **Neni 13 Dëmet e Likuiduara**

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zbrësë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet ti behen Ofruesit të Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbime parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të:

*a. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetëm në emër të vete Autoritetit, me një operatore ekonomik:*

- konfiskojë garancinë e performancës;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënie të pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë



koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

*b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:*

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

*c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:*

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

*a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:*

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofruesi i shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

#### **Neni 14 Siguria e Ekzekutimit**

14.1 Ofruesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

#### **Neni 15 Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit**

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

#### **Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave**

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi

i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

## **Neni 17           Kualiteti i Kontrollit**

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç është definuar në KVK.

## **Neni 18           Përmirësimi i Defekteve**

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

## **Neni 19           Konsekuencat e Shkeljes se kontratës**

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

#### **Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

#### **Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

#### **Neni 22 Dëmshpërblimi**

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbroje dhe do të dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do të jete përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, dëmet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

## KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë shqipe
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit caktohet me vendim të ZKA-se.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës me vlefshmëri prej 37 muaj.
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të jenë: <ul style="list-style-type: none"> <li>(a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre;</li> <li>(b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar.</li> <li>(c) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: <ul style="list-style-type: none"> <li>(i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</li> </ul> </li> </ul> <p>e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</p>
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: <i>Inspektimi do të bëhet nga persona të caktuar nga ZKA.</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	<i>Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) <i>Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore –Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.</i>  <i>ose</i>  b) <i>kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odes Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës</i>

		<p><i>Ndërkombëtare të Tregtisë.</i></p> <p><i>Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mos marrëveshjes, gjykata apo arbitrazh</i></p>
--	--	---

## Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

### *SPECIFIKAT TEKNIKE TË DETYRUESHME PËR SHËRBIMET E DDD NË INSTITUCIONET SHËNDETËSORE TË KPSH - QKMF DHE QMU*

#### *Deratizimi*

- Për deratizimin e objekteve shëndetësore duhet të përdoren preparate deratizuese - rodenticid - antikuagulant të gjeneratës së dytë.
- Preparatet deratizuese duhet të jenë në formë blloku me parafinë të qëndrueshme ndaj lagështisë për vendet me lagështi dhe preparatet në formë blloku, paste apo karemeve të freskët për vendet pa lagështi
- Preparatet deratizuese duhet të kenë Certifikatë të analizës (Certifikatë të A – Testit), afat të përdorimit.
- Preparatet deratizuese si substancë aktive duhet të kenë: Brodifacoum 0.005%, Bromadiolon 0.005%, Difethialone 0.0025%, Coumatetralyl 0.0367%
- Preparati deratizues duhet të vendoset në shtëpiza speciale me siguresa, qelës special në të cilat vendoset edhe mbishkrimi.
- Preparatet e vendosura në shtëpiza duhet të jenë në sasi prej 200gr. në 100m<sup>2</sup>
- Në vendet ku siguria duhet të jetë e lartë: njësitë pediatrike, njësitë e vaksinimit, njësitë e intervenimeve, kuzhina duhet të vendosen shtëpiza me ngjitës apo pllaka ngjitësi special.
- Ngjitësat të cilët përdoren duhet të kenë letër përçelëse nga kompanija që nuk janë toksike dhe nuk përbëjnë materiale të dëmshme.

#### *Dezinfektimi*

- Për kryerjen e këtij aktiviteti duhet të përdoren preparatet dezinfektuese të spektrit të gjërë të veprimit si jo irrituese dhe jo koroduese si në bazë të:
  - H<sub>2</sub>O<sub>2</sub> (peroksidit të hidrogjenit),
  - Komponentet aktive të amoniumit,
- Preparatet Dezinfektuese duhet të kenë Certifikatë të A-Testit, afat të përdorimit.
- Të jenë preparate që mund të përdoren në hapësira publike dhe objekte shëndetësore.
- Preparatet duhet të jenë të aplikueshëm përmes aparaturës ULV – ELEKTROSTATIKE (shpërndarës i spërklave në formë uniforme).
- Preparatet duhet të kenë veprim: baktericid, fungicid, virucid.
- Preparatet dezinfektuese duhet të përdoren në bazë të udhëzuesit të produktit i cili caktohet nga prodhuesi.

### *Dezinsektimi*

Për kryerjen e këtij aktiviteti duhet të përdoren preparatet dezinfektuese si:

- Preparate në formë Gelli.
- Stacione me ngjitës, atraktant për insekte - furtare dhe
- Preparate në formë të granulave apo solutione.
- Preparatet dezinfektuese në përbërjen e tyre duhet të kenë njërin nga substancat aktive si :
  - Clothianidin në formë gjeli 0.93%
  - Imidacloprid në formë gjeli 2.20%
  - Imidacloprid 10%
  - Z-9-Tricosene 0.1%
  - Bendiocarb 80.1%
  - Deltamethrin 20g/l

Preparatet Dezinfektuese duhen të kenë:

- Certifikatë të A-Testit ,
- Afat të përdorimit,
- Deklaratë të prodhuesit.

### **DDD SHËRBIMET**

DDD në institucionet e Kujdesit Parësor Shëndetësor duhet të kryhen në dy faza:  
Faza pranverore dhe  
Faza vjeshtore.

Hapësirat e objekteve për trajtim me DDD janë :  
Totali I M2 per te gjitha institucionet eshte: 21630

Nr. Rend	Emri I institucionit shëndetësor	Sipërfaqja në m <sup>2</sup>
<b>miQKMF</b>		
1	QMKF	5400
2	QMF 1	1000
3	QMF 2	500
4	QMF 3	462
5	QMF 4	1720
6	QMF 5	1643
7	QMF 6	1122
8	QMF 7	1320
9	QMF 8	700
10	QMF 9	400
11	QMF 10	400
12	QMF 11	800
13	QMF Mat 1	400
14	QMF Mat 1	400
15	QMF Hajvali	450
16	QMF Besi	700

Nr. Rend	Emri I institucionit shëndetësor	Sipërfaqja në m <sup>2</sup>
<b>AMF</b>		
1	AMF Barilevë	220
2	AMF Bardhosh	220
3	AMF Bullaj	85
4	AMF Dabishevc	80
5	AMF Llukar	120
6	AMF Mramuer	140
7	AMF Keqekollë	220
8	AMF Koliq	100
9	AMF Kishnicë	240
10	AMF Rimanishtë	90
11	AMF Viti	90
12	AMF Slivovë	85
13	AMF Shkabaj	110
14	AMF Sharban	120
15	AMF studenteve	80
	<b>Totali</b>	<b>2000</b>



<b>Totali</b>		<b>17417</b>
1	DAT	450
2	Poliklinika stomatologjike	663
3	QMU	1100
<b>TOTALI</b>		<b>2213m<sup>2</sup></b>

**Totali 21630  
m2**

" Deratizimi,dezinfektimi dhe dezinfektimi ne objektet shendetesore "

Nr.	Artikulli	Sasia	Njesia	Çmimi per njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
1	DDD ne Institucionet Shendetesore KPSH - QKMF dhe QMU	21630	m2	2.75	59,482.50



Për: KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES  
(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues")

Në emër të: DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K., Mehmet Akif Ersoy, Nr.17 Taslixhe , II, Prishtinë  
(në vazhdim "operatori ekonomik")

Titulli i aktivitetit të prokurimit: DERATIZIMI, DEZINFEKTIMI DHE DEZINSEKTIMI NË OBJEKTET  
SHËNDETËSORE

Numri i prokurimit: 616-21-3073-2-2-1 (616 21 086 221)

## SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Garancion

Nr.Serik i polices: 151/21

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;  
DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e Tenderit;  
DHE NGASE NE jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri:

ANDAJ NE të poshtë-nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **5,948.25 ( pesë mijë e nëntë qind e dyzet e tetë, e njëzet e pesë të qindtat Euro )** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substancionale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë; dhe
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe /ose furnizues të materialeve.


Pagesa në shumën e limituar prej: **5,948.25 Euro** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin "e pranimit".

**Kjo siguri është e vlefshme 1127 ditë prej 16.07.2021 deri më 15.08.2024**

Kompania e Sigurimeve "EUROSIG" Sh.a.  
Rruga "2 Korriku", Nr.4, 10000 Prishtinë, Kosovë

Data: 16.07.2021



POLICA E SIGURIMIT TË GARANCISË GUARANTEE INSURANCE CERTIFICATE			Nr.policës Policy No	151/21
I SIGURUARI DEBITORI KRYESOR	DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K.	SPECIALISTI/AGJENTI	EUROSIG	
NUMRI I BIZNESIT	811498957	KODI I SPECIALISTIT AGJENTIT	22	
NUMRI FISKAL		DREJTORIA/FILIALI AGJENTIT	QENDRA NË PRISHTINË	
ADRESA	Prishtinë, 10000, Mehmet Akif Ersoy, Nr.17 Taslixhe , II	NUMRI I BIZNESIT SIGURUESI	811296054	
PËRFAQËSUESI DEBITORI SOLIDAR	LULZIM KATANOLLI	NUMRI FISKAL SIGURUESI	811296054	
NUMRI PERSONAL IDENTIFIKUES	1019465027	ADRESA E DREJTORISË SIGURUESI	Rr. "2 Korriku", nr. 4, Prishtinë, 10000	
SIGURIMI/GARANCIA FILLON MË	16.07.2021	PRIMI I SIGURIMIT	275.08 €	
SIGURIMI/GARANCIA PËRFUNDON MË	15.08.2024	TATIMI I VLERËS SË SHTUAR 18%	49.52 €	
SHUMA E SIGURUAR	5,948.25 €	SHUMA PËR PAGESË	324.60 €	
DATA E LËSHIMIT TË POLICËS	16.07.2021	DATA E PAGESËS	16.07.2021	
PËRFITUESI/AUTORITETI KONTRAKTUES	KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES			
ADRESA	Prishtinë, Rr.Trepqes nr.2			
TITULLI I KONTRATËS:	DERATIZIMI, DEZINFEKTIMI DHE DEZINSEKTIMI NË OBJEKTET SHËNDETËSORE			
NUMRI I IDENTIFIKIMIT PROKURIMIT	616-21-3073-2-2-1 (616 21 086 221)			
LLOJI I SIGURIMIT GARANCISË	SIGURIMI I GARANCONIT TË KONTRATËS / PERFORMANCE BOND INSURANCE			
ÇERTIFIKATA E GARANCISË DHE KJO POLICË SIGURIMI VËRTETOJNË LIDHJEN E KONTRATËS, DHE LËSHOHEN NGA SIGURUESI NË BAZË TË DEKLARIMEVE DHE KERKESAVE TË BËRA NGA PËRFAQËSUESI I TË SIGURUARIT, I CILI ËSHTË PËRGJEGJËS LIDHUR ME SAKTËSINË DHE VËRTETËSINË E DEKLARIMEVE TË BËRA PREJ TUJ				
UNË PËRFAQËSUESI I TË SIGURUARIT, PASI I LEXOJME VËRTETËSINË DHE I KUPTOVA KUSHTET E KONTRATËS SË SIGURIMIT, DEKLAROJ SE PAJTOHEM ME TO, SI DHE ME TË DHËNAT DHE PËRCAKTIMET E ÇERTIFIKATËS SE GARANCISË DHE TË KËSAJ POLICE SIGURIMI, DHE PO NËNSHKRUAJ KONFORM VULLNETIT TIM TË LIRË, E TË PLOTË				
SIGURUESI	 Kompania e Sigurimeve Eurosig sh.p.a.		I SIGURUARI	

**POLICA E SIGURIMIT TË PËRGJEGJËSISË PUBLIKE DHE TË PRODUKTIT**  
**PUBLIC AND PRODUCT LIABILITY INSURANCE POLICY**Nr. policës  
Policy No

93/21

Përfaqësia  
Branch Office

Qendra në Prishtinë

Agjenti  
Agent

Eurosig

I siguruari / Emri dhe mbiemri  
Insured / Name and surname

DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K.

Adresa  
Address

Prishtinë, Mehmet Akif Ersoy, Nr.17 Taslixhe , II

Nr. biznesit  
Business No.

811498957

Adresa e Objektivit të siguruar  
Address of Insured ObjectPeriudha e sigurimit fillon me datën dhe orën  
Period of insurance starts, date and time

17.07.2021 00:00

Mbaron me datën dhe orën  
Ends, date and time

15.08.2024 24:00

Interesi i siguruar  
Insured Interest

PËRGJEGJËSIA NDAJ PALËVE TË TRETA /THIRD PARTY LIABILITY

Përshkrimi i veprimtarisë  
Description of activity

Shërbime të DDD (Dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim)

**Limiti i përgjegjësisë së siguruar / Limits of the insured liability**

Për njerëz

50,000 (pesëdhjetë mijë Euro) Për çdo ndodhi

Limiti i përgjithshëm

65,000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë Euro) Për çdo ndodhi

**Pjesa e zbritshme / Deductible**Për dëmet në njerëz  
Bodily injuries

10 % MINIMUMI 2,000.00 € (Përçdo ndodhi)

Për dëmet në pasuri  
Damages to properties

10 % MINIMUMI 2,000.00 € (Përçdo ndodhi)

**PRIMI  
PREMIUM**

Primi / Premium		TVSH / VAT 18 %		Primi total / Total Premium	
300.00	Euro	54.00	Euro	354.00	Euro

Kjo policë siguri është lidhur në bazë të ligjit mbi detyrimet, përkatësisht Rregullores për Sigurimin e Përgjegjësisë Publike dhe të Produktit, dhe me licencën e aprovuar për këtë produkt nga BQK. Pjesë përbërëse të kësaj policë janë Kushtet e Përgjithshme të sigurimit të Përgjegjësisë, pyetësori, klauzolat për mbullimet shtesë si dhe të gjitha dokumentet tjera të bashkëlidhura me policën e sigurimit.

This insurance policy is issued based on the law on liabilities, respectively on the Regulation for Public and Product Liability Insurance, and with the approved license issued by CBK. Forming parts of this insurance policy are General Conditions for Liability Insurance, proposal form, endorsements for additional cover and all documents attached to this insurance policy.

**Vërejtje / Notes**

- Limiti për çdo ndodhi për dëme materiale është 15,000.00 €.

- Kjo policë vlen vetëm për punimet që lidhen me tenderin e Komunës së Prishtinës me titull: "Deratizimi, dezinfektimi dhe dezinfektimi në objektet Shëndetësore", me nr. të prokurimit: 616-21-3073-2-2-1 dhe nr të brendshëm: 616 21 086 221.



Data &amp; Ora - Date &amp; Time

16.07.2021 12:29:19

I siguruari - Insured

DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K.

Për



**1. KLAUZOLA OPERATIVE**

Me kusht që i Siguruarit (përfaqësuesi dhe/ose pronari) për qëllimin e këtij sigurimi, të ketë paguar më parë primin e sigurimit, Siguruesi kushtezuar nga afalet, përjashtimet dhe kushtet e situara ose të bashkëlidhura me këto kontrate, me anën e Memorandumëve, bie dakord të dëmshpërblejë të Siguruarin për Përgjegjesinë ndaj Palëve të Treta, për të paguar dëme (duke përfshirë shpenzimet, taksat dhe kostot e kërkuarit të dëmshpërblimit), për të cilat i Siguruarit behet përgjegjes legalisht, gjyqesisht dhe vërtetohet si i tillë (përgjegjes), nga një Arbiter i pranuar nga palët, në përputhje me ligjet e vendit. Ky dëmshpërblim zbatohet vetëm për ato përgjegjesi gjatë periudhës së sigurimit, të cilat janë të përcaktuara nga secili Seksion i Siguruarit i kesaj police, në lidhje me një ngjarje sigurimi, që ndodh brenda territorit, ku ushtron aktivitetin e tij të licencuar, i Siguruarit.

**2. PËRKUFIZIME:**

Per qëllimin e përcaktimit të ngjarjes së sigurimit, do të zbatohen Përkufizimet e mëposhtme:

**2.1 Ngjarjet e Siguruara**

- 2.1.1 Ngjarjet e përkufizuara me poshtë si dëme personale dhe pasurore, të cilat janë të papritura dhe të padëshiruara nga i Siguruarit, mbulohehen nga Siguruesi në qoftë se ato vërtetohet se kanë ndodhur ose filluar gjatë periudhës së sigurimit nga kjo police, dhe janë shkaktuar gjatë ushtrimit të zakonshëm të aktivitetit të licencuar të Siguruarit dhe i janë raportuar Siguruesit brenda periudhës së sigurimit të kesaj police.
- 2.1.2 Në rastet e paqarta Dëme Personale dhe Pasurore do të konsiderohen, për qëllimin e kesaj police të kenë ndodhur
  - 2.1.2.1 Për dëme personale, në datën më të hershme (brenda periudhës së sigurimit) në të cilën një person konsultohet me një mjek specialist, lidhur me shqetësimet e tij mbi simptomat që diagnostikohen të kenë filluar e vijnë nga ngjarja e siguruar.
  - 2.1.2.2 Për dëme pasurore, në datën më të hershme (brenda periudhës së sigurimit) në të cilën një person mund të provojë se ka marrë dënim mbi humbjen, e cila provohet të jetë shkaktuar nga ngjarja e sigurimit.
  - 2.1.2.3 Do të konsiderohet "një ngjarje e vetme sigurimi" çdo dëm ose seri dëmshme, të shkaktuara nga një rrezik i mbuluar prej këtyre kushteve të përgjithshme, që ndodh në një moment të caktuar, gjatë periudhës së sigurimit.
  - 2.1.2.4 "Kufiri maksimal i dëmshpërblimit (limiti agregat)" shpreh vlerën maksimale që çdo perfitues ose perfituesit mund të perfitojnë nga kjo police, për çdo një periudhë sigurimi. Kjo vlerë (agregat) e dëmshpërblimit që përfshihet në periudhën e sigurimit, shënohet në policën e sigurimit.
- 2.2 "Dëme Personale" do të konsiderohen të jenë vdekje, plagosje, dopesi, sëmundje, çrregullime, paafësi, gjendje shoku, tmerr, dëmtime dhe vuajtje psikike e çdo personi, i cili nuk është punonjës apo familjar i të Siguruarit.
- 2.3 "Dëme Pasurore" do të konsiderohen të jenë dëmtimi fizik, dhe/ose humbjen e përdorimit dhe/ose shkatërimi i pasurisë së paluajtshme ose të luajtshme, që nuk është pronë dhe/ose zotërohet dhe/ose marrë me qera prej të Siguruarit, përfaqësuesve të tij, kontraktorëve, nënkontraktorëve dhe/apo anëtarëve të tij të familjes, në mënyrë të ligjshme.
- 2.4 "Punonjës"
  - 2.4.1 Punonjës do të konsiderohet të jetë personi fizik që ka një kontratë pune (përfshirë periudhën e provës) me të Siguruarin dhe/ose është familjar i tij.
  - 2.4.2 Punonjës do të konsiderohet të jetë çdo person fizik i vetëpunësuar ose jo, që kryen shërbime të ndryshme për llogari të aktivitetit dhe në territorin ku ushtron këtë aktivitet i Siguruarit, pavarësisht nëse ka ose jo një marrëveshje për kryerjen e shërbimeve të tilla, me të Siguruarin.
  - 2.4.3 Punonjës do të konsiderohet të jetë edhe çdo person, i punësuar në një kompani tjetër, por me të cilin i Siguruarit ka nënshkruar një kontratë shërbimi, furnizimi, përpunimi, hulumtimi, tregtimi, prodhimi, auditi etj.
- 2.5 Palë e tretë nënkupton çdo person fizik dhe juridik që nuk mund të konsiderohet i përfshirë në paragrafin 2.2, 2.3 dhe 2.4 (më sipër) të kesaj kontrate.
- 2.6 "Aktiviteti i licencuar"
- 2.6.1 Aktiviteti i licencuar do të konsiderohen të jenë vetëm ato veprimtari, si psh furnizimi, prodhimi, hulumtimi, shërbimi, shfrytëzimi, tregtimi, përpunimi etj., të licencuara, që i Siguruarit i ka marrë nga institucionet, organet përgjegjëse shtetërore të Republikës së Kosovës, në territorin e përmendur në këtë licencë.
- 2.6.2 Aktiviteti i licencuar sipas kesaj kontrate sigurimi do të konsiderohen të jenë veprimtari/aktiviteti i licencuar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) për "Hulumtimin, Shfrytëzimin dhe Lejet e veçanta/për punë të posaçme (për Miniera dhe Minerale)".
- 2.7 "Ndotes" do të konsiderohen të jenë çdo ngacmues ose infektues i ngurtë, i lëngshëm, i gaztë ose termik duke përfshirë por pa u kufizuar ndër ta, si tymi, avulli, blloza, acidet, bazat, alkalinet, kimikatet, të cilat janë të aftë të shkaktojnë dëme personale dhe pasurore, nga veprimi direkt i tyre ndaj palëve të treta në ambientet ku i Siguruarit ushtron aktivitetin e tij.
- 2.8 "Automjet", do të konsiderohet të jetë një mjet motorik tokësor, rimorkio ose gjysmërimorkio.

**3. DËMSPËRBLIMI**

- 3.1 Siguruesi dëmshpërblen të Siguruarin e identifikuar ligjërisht përgjegjës, për ngjarjen e cila konsiderohet "aktiviteti i licencuar" në përputhje me parashikimet e klauzolës operative, gjithnjë në konsideratë të përkufizimeve, limit të dëmshpërblimit/kufijve dhe përjashtimeve, të këtij Seksioni.
- 3.2 I Siguruarit (përfaqësuesi dhe/ose pronari) nuk mund të justifikohet në asnjë rast për mos njohjen e kushteve të kontratës së sigurimit, përkufizimit, përjashtimit dhe limitet maksimale të mbulimit për çdo person që konsiderohet palë e tretë.
- 3.3 Shumat e mbuluara për "dëme personale" dhe për "dëme pasurore", janë si më poshtë:
  - 3.3.1 Për çdo një ngjarje të siguruar kufiri maksimal i dëmshpërblimit do të jetë 50,000.00 Euro.
  - 3.3.2 Kufiri maksimal (limiti agregat gjatë periudhës së sigurimit) është i dëmshpërblimit do të jetë 65,000.00 Euro.
- 3.4 Shpenzimet ligjore: Siguruesi do të paguajë të gjitha kostot ligjore, shpenzimet e shërbimit dhe gjithashtu dhe shpenzimet e kryera me pelqimin e tij, prej të Siguruarit për mbrojtjen ose pagesën e çdo kërkesë për dëmshpërblim në përputhje me parashikimet e këtyre kushteve të përgjithshme, që këtu e me poshtë do të quhen kostot e mbrojtjes. Kostot e mbrojtjes i shtohen shumës së dëmshpërblimit për dëmet e vërtetuara personale dhe pasurore, por gjithmonë pa tejkaluar vlerat kufinj të parashikuar në kete seksion. Kostot e mbrojtjes përfshijnë shpenzimet ligjore:
  - 3.4.1 Që rrjedhin prej perfaqësimit në çdo hetim dhe shqyrtim gjyqësor, të aksidenteve fatale.
  - 3.4.2 Që rrjedhin prej mbrojtjes nga çdo padi në një gjykatë, lidhur me çështje, të cilat mund të përbëjnë objekt dëmshpërblimi, sipas kesaj police.

**4. PËRJASHTIME - Kjo policë sigurimi nuk do të zbatohet për:**

- 4.1 Përgjegjësinë në lidhje me "dëmtimet pasurore", të përcaktuara sipas pikës 2.3 të kesaj kontrate sigurimi.
- 4.2 Përgjegjësinë në lidhje me dëmtimet personale të çdo "punonjësi", të përcaktuar sipas pikës 2.4 të kesaj kontrate sigurimi.
- 4.3 Përgjegjësinë në lidhje me çdo ngjarje që vjen si rrjedhojë e një veprimtari që nuk përbën dhe nuk konsiderohet "aktiviteti i licencuar" sipas pikës 2.6 të kesaj kontrate sigurimi.
- 4.4 Çdo përgjegjësi e çdo lloj natyre që shkaktohet, vjen ose ndikon, direkt ose indirekt nga ndotja e ajrit, ujit ose tokës, sipas pikës 2.7 të kesaj kontrate
- 4.5 Dëmet në pasurinë e luajtshme apo të paluajtshme në pronësi, ose të fituar ligjërisht, në zotërim ose përdorim nga i Siguruarit (përfaqësuesi dhe/ose pronari) apo anëtarët e tij të familjes, si të lidhur me pasurinë në funksion të ushtrimit të aktivitetit të të Siguruarit, apo për çfarëdo qëllimi tjetër ndryshe.
- 4.6 Përgjegjesia në lidhje me humbjen ose dëmtimin e pasurisë, që i përket të Siguruarit (përfaqësuesi dhe/ose pronari), anëtarëve të familjes, përpunohet nga/ose është nën kujdesin, ruajtjen, kontrollin e të Siguruarit ose çdo personi tjetër të punësuar nga/ose që punon për të Siguruarin.
- 4.7 Përgjegjesia në lidhje me çdo ngjarje që vjen si rrjedhojë e një veprimi të qëllimshëm dhe të pandershëm ose pakujdesia e të Siguruarit (përfaqësuesi dhe/ose pronari) dhe/ose familjarëve të tij, dhe/ose punonjësve të tij.
- 4.8 Çdo përgjegjësi e çfarëdo natyre që direkt ose indirekt është shkaktuar nga/ose që rrjedh nga:
  - 4.8.1 Rrezatimi ose ndotje jonizuese nga radioaktiviteti prej lëndëve bërthamore ose prej rrjedhjeve bërthamore ose djegja e karburanteve bërthamore.
  - 4.8.2 Eksplozivet toksike radioaktive ose lëndë të tjera të rrezikshme të perberjeve eksplozive bërthamore ose pjesëve perberese të tyre.
  - 4.8.3 Asbestit ose sëmundje të tjera që lidhen me të (përfshirë kancerin) që rrjedhin nga egzistenca, prodhimi, trajtimi, përpunimi, shitja, shpërndarja, magazinimi, depozitimi ose përdorimi i asbestit dhe/ose produkteve që përmbajnë asbest.
- 4.9 Përgjegjesia në lidhje me çdo ngjarje që shkaktohet, apo vjen si rrjedhojë (direkte ose indirekte) e:
  - 4.9.1 Gjobave, penaltiteteve, masave ndëshkuese ose shembullore, konfiskimit nga institucionet/organet përgjegjëse shtetërore.
  - 4.9.2 Luftës, akteve të luftës, pushtimit, veprimeve të armiqve të jashtëm (në luftë ose jo), lufta civile, revolucionit, ndërhyrja ushtarake, akteve terroristike, akteve keqdashëse, grevave, trazirave, turbullirave civile, vandalizmi, vjedhjes, grabitjes dhe sabotimi.
  - 4.9.3 Zjarrit, eksplozionit, implozionit, rufese, rënies së avionit/aeroplanit, pjesëve dhe ose ngarkesë së avionit